

PROCESVERBAL
nga seanca e 4. e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale
mbajtur më 28.1.2026

Anëtarët e Këshillit të Agjencisë të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Sasho Stefanovski, mr. Zirjeta Jajaga, mr. Gordana Majnova, Afrona Vërzivolli, Cvetanka Minovska, Petar Xhurovski, Viktor Pavlovski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajčevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Të punësuar nga shërbimi profesional të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë: Cvetanka Mitrevska, mr. Emilija Janevska, Maja Damevska, mr. Ruzhica Boshnakoska-Jotevska, dr. Ivana Stojanovska, mr. Gorjan Sheqerinov.

Të pranishmit e tjerë: /

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, hapi seancën e 4. të Këshillit. Seanca filloi në ora 13:35 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit të seancës së 3-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 21.1.2026.
2. Propozim për miratimin e Raportit për transmetim të reklamave politike me pagesë në programet e transmetuesve, gjatë kohës së fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e përsëritura për Kryetar të komunës së Gostivarit, komunës Vrapçishtë, komunës Mavrovë dhe Rostushë dhe komunës Qendër Zhupë, në periudhën nga 22 dhjetor 2025 deri më 9 janar 2026.
3. Propozim-aktvendim për fshirjen nga regjistri i radiodifuzerëve të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV M Arnaudov Mihajlo Ohrid ShPKNJ.P.
4. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli shqyrtoi dhe njëzëri miratoi procesverbalin e propozuar të seancës së 3-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 21.1. 2026, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Udhëheqësja e Sektorit për çështje programore, mr. Emilija Janevska, shpjegoi Raportin mbi transmetimin e reklamave politike me pagesë të transmetuesve gjatë kohës së fushatës zgjedhore për zgjedhjet e përsëritura për kryetar komune në komunat Gostivar, Vrapçisht, Mavrovë dhe Rostushë dhe Qendër Zhupë, të cilat u mbajtën në periudhën nga 22 dhjetor 2025 deri më 9 janar 2026. Ajo sqaroi se, në pajtim me Kodin Zgjedhor, Agjencia ka detyrim në ditën e njëzetë pas heshtjes zgjedhore të paraqesë raport në Komisionin Shtetëror Zgjedhor për reklamimat politike me pagesë të transmetuesve. Të dhënat e përfshira në raport janë marrë nëpërmjet monitorimit të plotë të radiodifuzerëve të regjistruar për transmetim të reklamimit të paguar politik, dhe janë kontrolluar shtesë sipas procedurës për konfirmim të raporteve për shërbimet e realizuara, që gjithashtu paraqet detyrim ligjor. Në pajtim me Orarin e KSHZ-së për zbatimin e veprimtarive zgjedhore për këto zgjedhje të përsëritura, dita e njëzetë e heshtjes zgjedhore bie më 29 janar. Për arsyet e përmendura, propozohet që Këshilli i Agjencisë ta miratojë Raport, pas së cilës ai do të publikohet në ueb faqen e Agjencisë dhe do t'i dorëzohet Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve. Lidhur me përmbajtjen e Raportit, u tha se gjatë kohës së fushatës zgjedhore për zgjedhjet e përsëritura, kontrata për transmetim të reklamave politike me pagesë kanë lidhur gjithsej nëntë transmetues, nga të cilët shtatë televizione dhe dy radio. Në televizione dhe radio së bashku u transmetuan gjithsej 87,614 sekonda reklama politike me pagesë, e cila është 24 orë, 20 minuta dhe 14 sekonda. Hapësirë më të madhe të kohës për reklama transmetuan televizionet lokale TV G-TV dhe TV Due nga Gostivari. Nga radiot, vetëm Radio Kometa 2000 nga Gostivari dhe Radio 7 nga Tetova kanë lidhur kontratë për reklama politike me pagesë, nga ku Radio Kometa transmetoi 8,664 sekonda dhe Radio 7 transmetoi 6,845 sekonda reklama politike me pagesë. Në televizione, hapësirë më të madhe të kohës për reklama morrën dy koalicionet – Aleanca Kombëtare për Integrim (AKI) dhe koalicioni VLEN, ndërsa koalicioni i udhëhequr nga LSDM ka marë hapësirë në televizionin Kanal 5, në hapësirë kohe shumë të vogël, përkatësisht 26 minuta dhe 20 sekonda. Në dy radio, kohë për transmetim të reklamave politike me pagesë morën vetëm koalicionet NAI dhe VLEN. Shikuar në total për të gjithë transmetuesit, kohë më të madhe për reklamim mori koalicioni NAI, në total prej 60 258 sekonda ose 16 orë 44 minuta dhe 18 sekonda. Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE, Partia Demokratike e Turqve në Maqedoni, si dhe kandidati i pavarur Zulijhajrat Demiri, edhe pse pjesëmarrës në fushatën zgjedhore, nuk morën hapësirë për transmetim të reklamave politike me pagesë në programet e transmetuesve. Të dhëna mbi transmetimin e reklamave politike me pagesë në shtatë kanalet televizive dhe dy radiot shfaqen në formë tabelare, të shprehura në sekonda dhe të shpërndara në tre periudha kohore gjatë ditës dhe natës, në pajtim me formularin e përcaktuar nga Komisioni Shtetëror Zgjedhor.

Kryetari i Këshillit deklaroi se së bashku me anëtarët e Këshillit e shqyrtuan Raportin dhe tabelat e përfshira në të dhe konstatuan se është përgatitur në mënyrë cilësore dhe nuk përmban asnjë lëshim ose gabim.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Raportin për reklamat politike me pagesë të programeve të transmetuesve, gjatë kohës së fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e përsëritura për Kryetar të komunës së Gostivarit, komunës Vrapçisht, komunës Mavrovë dhe Rostushës dhe komunës Qendër Zhupë, në periudhën nga 22 dhjetor 2025 deri më 9 janar 2026, me tekstin e propozuar.

Në pajtim me Orarin e Komisionit Shtetëror Zgjedhor për zbatimin e veprimtarisë zgjedhore, Raporti për reklamat politike me pagesë të transmetuar në programet e radiodifuzerëve, gjatë kohës së fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e përsëritura për Kryetar të komunës së Gostivarit, komunës Vrapçisht, komunës Mavrovë dhe Rostushës dhe komunës Qendër Zhupë, në periudhën nga 22 dhjetor 2025 deri më 9 janar 2026, do t'i dorëzohet Komisionit Shtetëror Zgjedhor më 29 janar 2026.

Sektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, Raportin e lartpërmendur ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 3

Drejtori i Agjencisë, dr. Zoran Trajčevski, shpjegoi aktvendimin e propozuar për fshirjen nga Regjistri i Radiodifuzerëve të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV M Arnaudov Mihajlo Ohrid ShPKNJ. Ai shpjegoi se, në pajtim me dispozitat ligjore, pas heqjes së lejes për transmetim, përkatësisht pas ndalimit të vlefshmërisë së lejes, Këshilli i Agjencisë është i detyruar të miratojë vendim për fshirjen nga regjistri i radiodifuzerëve. Në rastin konkret, radiodifuzeri në mënyrë të pavarur e ka kthyer lejen për transmetim televiziv, nga ku plotësohen kushtet për fshirjen e tij nga regjistri. Miratimi i vendimit ka karakter formal dhe përfaqëson informim të publikut se radiodifuzeri në fjalë pushon së ekzistuari dhe nuk do të jetë pjesë e Regjistrit të Radiodifuzerëve të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski theksoi se kishte shqyrtuar të gjitha dokumentet e paraqitura, përfshirë dhe deklaratat e noterizuara për heqje dorë (renoncim) të lejes për transmetim, si dhe kërkesën e paraqitur në Agjencion për fshirjen nga Regjistri i Radiodifuzerëve. Ai vlerësoi se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore dhe teknike për fshirjen nga regjistri me kërkesë të vetë transmetuesit. Ai gjithashtu theksoi se me miratimin e këtij vendimi, evidentohet ndërprerja e punës së një mediumi, duke shprehur pritshmërin se në të ardhmen do të ketë mundësi për të forcuar përsëri ofertën mediatike në rajonin e përmendur.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Aktvendim për fshirjen nga regjisrti i radiodifuzerëve të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV M Arnaudov Mihajlo Ohrid ShPKNJ.

Aktvendimi për fshirjen nga regjistri i radiodifuzerëve të ShTR TV M Arnaudov Mihajlo Ohrid ShPKNJ hyn në fuqi menjëherë dhe do të zbatohet pas pagesës së tarifës për Lejen e transmetimit televiziv, PA1 nr.08-39 datë 7.9.2023 nga transmetuesi në pajtim me faturën e dhënë nga Agjencia vetëm për periudhën e punës, përkatësisht nga 24.12.2025 deri më 23.1.2026.

Sektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e lartpërmendur ta publikojë në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" dhe në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 4

Të ndryshme

Këshilltarja Afrona Vërziovollli shtroj pyetjen nëse Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TV M Arnaudov Mihajllo Ohrid ShPKNJ P i ka shlyer të gjitha detyrimet financiare ndaj Agjencisë. Në përgjigjen e tij, drejtori i Agjencisë, dr. Zoran Trajčevski, shpjegoi se transmetuesit iu lëshua faturë më 25 dhjetor 2025. Gjatë kësaj periudhe, transmetuesi njoftoi se do ta kthente lejen e transmetimit, por më vonë ndërroi mendje dhe njoftoi se do të vazhdonte me punë, pas së cilës Agjencia i lëshoi një faturë për tarifën e lejes për transmetimit televiziv për vitin 2026. Afati prej 30 ditësh për pagesën e faturës skadon sot ose nesër dhe ajo ende nuk është shlyer. Prandaj, Agjencia duhet të korrigjojë faturën dhe të lëshojë faturë të re për periudhën nga dita e fshirjes nga regjistri, të cilën transmetuesi do të duhet ta paguajë. Përndryshe, do të iniciohet procedurë për pagesë në rrugë gjyqësore.

Këshilltarja Cvetanka Minovska shtroj pyetje drejtuar shërbimit profesional në lidhje me pikën për dhënien miratim për shërbime avokatie, e cila u shqyrtua në njërën nga seancat e mëparshme të Këshillit. Ajo kujtoi se, me kërkesë të saj, shërbimi profesional kishte për detyrë të dorëzonte të dhëna statistikore për numrin e lëndëve që zyra e avokatëve i përfaqësoi gjatë vitit 2025, por edhe pas një muaji, të dhëna të tilla ende nuk ishin dorëzuar. Në përgjigje, drejtori Trajčevski informoi se raporti me të dhënat e kërkuara statistikore do t'u dorëzohet të gjithë anëtarëve të Këshillit deri në fund të javës vijuese.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Zëvendëse e kryetarit të Këshillit,
mr. Zirjeta Jajaga**